



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës:	2022:232583
Datë:	08.06.2023
Numri i dokumentit:	04373623
Dosja fizike:	C-IV-21-0197

N B nga Fshati P i R, Komuna e Gllgovcit.  
I përfaqësuar nga I S avokat nga Prishtina

*Paditësi*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 Lakrishtë, Prishtinë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 08.06.2023, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Miratohet si bazuar kërkesëpadia e paditësit N B ashtu që:

- Anulohet vendimi (korrigjues) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit me numër PRN035-0876, i datës 16.05.2016; dhe
- Ndryshohet vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit me numër PRN035-0876, i datës 22.07.2014, vetëm lidhur me kamatën ligjore të vonesës, ashtu që detyrohet e paditura Agjencia Kosovare e Privatizimit - Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore “Ramiz Sadiku”, që paditësit t’ia paguaj shumën 6,754.00 €, në emër të kompensimit te faturës me numër 19/05 si dhe shumën prej 675.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 7,429.00 €, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

II. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit N B përkitazi me kamatën e kërkuar dhe atë, mbi shumën e miratuar me këtë aktgjykim, prej 10 % të borxhit total, e deri në shumën e kërkuar në normën prej 8 % në vit.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shumën prej 124.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së

përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

### **Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 31.03.2016, paditësi ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), me shenjë PRN035-0875, të datës 16.05.2016.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Në padi, paditësi ndër të tjera ka theksuar: pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 6,754.00 €, në emër të kompensimit të faturës me numër 19/15 të datës 30.04.2005, nga NSH Ramiz Sadiku. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin me numër PRN035-0876, e ka miratuar atë si të bazuar. Pastaj, Autoriteti i Likuidimit me datën 16.05.2016, ka nxjerrë vendim të korigjuar përmes të cilit e ka ndryshuar vendimin fillestar ku e ka zbritur shumën prej 3,437.00 €, nga shuma e miratuar me vendimin fillestar. Ka pretenduar se vendimi korigjues i AL-së është nxjerrë në shkalleje esenciale të dispozitave të procedurës administrative; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale juridike. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija të aprovohet si e bazuar dhe me aktgjykim të anulohet vendimi i korigjuar i AL-së me numër PRN035-0876, i datës 16.05.2016 dhe të mbetet në fuqi vendimi fillestar me numër PRN035-0876, i datës 22.07.2014; dhe të detyrohet pala e paditur që shumën e aprovuar me vendimin fillestar prej 6,754.00 €, t’ia kompensoj me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 22.07.2014, e deri në pagesën definitive. Pala paditëse bashkë me padi ka dorëzuar edhe vendimet me numër PRN035-0876 të datave 16.05.2016 dhe 22.07.2014.

Me datën 23.06.2016, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Më tutje, ka theksuar se AL e ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga pala paditëse dhe me nxjerrë vendimin me numër PRN035-0876, të datës 22.01.2014, ku e ka miratuar në tërësi kërkesën për kompensim të borxhit. Mirëpo AL ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga paditësi siç janë kontrata e datës 03.03.2003, e nënshkruar prej tij dhe faturën e drejtuar NSH-së dhe pas shqyrtimit të arkivës së NSH-së AL ka konstatuar se pala paditëse e ka një detyrim ndaj ndërmarrjes. Andaj ka nxjerrë vendimin tjetër ku nga shuma e aprovuar e ka zbritur detyrimin e palës paditëse në shumën prej 3,437.00

€. Me përgjigje në padi është propozuar që të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL.

### **Gjendja faktike e konstatuar**

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç’do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Pala paditëse ka dorëzuar provat si në vijim: kontrata e lidhur në mes të palës paditëse dhe NSH-së me datën 03.03.2003; dhe faturën me numër 19/05, të datës 30.04.2005.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë analizën e fakteve dhe provave të prezantuara nga palët në procedurë, konform rregullave që rrjedhin nga neni 8.1 i LPK-së dhe dispozitat tjera ligjore të ndërlidhura.

Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe analiza e provave të prezantuara, gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet vendimtare të prezantuara nga pala paditëse, janë jo kontestuese, madje të mbështetura edhe në provat që ka prezantuar, si në vijim:

Paditësi dhe NSH Ramiz Sadiku me datën 03.03.2003, kanë lidhur kontratë për kryerjen e punimeve me eskavator, respektivisht për të bërë ngarkimin e gurëve në gurëthyesin me seperacion Kalaja e Drenicës – Q e V, Gllogovc. Në lidhje me këto punë ndërtimore të kryera pala paditëse ka lëshuar faturën me numër 19/05, të datës 30.04.2005, në shumën prej 6,754.00 € të cilin obligim nuk e ka përbushë Ndërmarrja. Pranë AL-së ka parashtruar kërkesë kreditore për pagesën e faturës së lëshuar në shumën prej 6,754.00 €. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse dhe me vendimin me numër PRN035-0876, të datës 22.07.2014, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka miratuar në tërësi si të bazuar. Në lidhje me detyrimin e lartë cekur me datën 16.05.2016, pala e paditur ka lëshuar një vendim tjetër (vendim të korrigjuar) me të cilin palës paditëse ia ka aprovuar pjesërisht kërkesën kreditore ku ia ka aprovuar shumën prej 3,317.00 €, ndërsa shumën prej 3,437.00 €, e ka refuzuar. AL me anë të vendimit të korrigjuar ia ka zbritur palës paditëse shumën prej 3,437.00 €, me pretendimin se pala paditëse ka një detyrim ndaj ndërmarrjes dhe se kjo është bërë pas shqyrtimit të arkivës së ndërmarrjes.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural

i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se “*në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*”.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- 4.1, *Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.*

- 4.2, *Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.*

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritor pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 398 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

*“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.*

Siç është shtjelluar më sipër, në këtë çështje kontestimore, faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese. Pala paditëse ka kryer punime në dobi të ndërmarrjes bazuar në raportin kontraktues dhe se vlera e këtyre punimeve ka qene në shumën prej 6,754.00 €. AL në procedurë të likuidimit ia ka aprovuar këtë shumë me vendimin e datës 22.04.2014. Me datën 16.05.2016, AL ka nxjerrë vendim korrigjues me të cilin palës paditëse ia ka zbritur shumën prej 3,437.00 €. Andaj, objekt

shqyrtimi në këtë çështje, ishte ligjshmëria e vendimit të korigjuar të AL-së dhe çështja e kamatës ligjore të vonësës.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia është e bazuar.

Pas vlerësimeve të bëra në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se vendimi i datës 16.05.2016, nuk është vendim korigjues por është vendim i dytë i Autoritetit të Likuidimit për të njëjtën çështje. Me vendimin në fjalë është ndryshuar shuma e aprovuar për kreditorin nga 6,754.00 €, sa ishte në vendimin e parë, në shumën prej 3,437.00 €. Pra, nuk kemi të bëjmë me korigjim teknik por me ndryshim të vlerës në emër të kompensimit të kërkesës kreditore të palës paditëse. Me nenin 74 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është e përcaktuar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund të atakohet me ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe vetëm Dhoma e Posaçme mund ta ndryshoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe se Autoriteti i Likuidimit nuk posedon me autorizime ligjore për të ndryshuar vendimin e vet. Kur AL-ja lëshon një vendim mbi aprovimin e kërkesës kreditore, ai vendim bëhet detyrues për të gjitha palët në procedurë, madje edhe për vet AL-në, dhe se vendimi si i tillë mbetet në fuqi deri në anulimin apo ndryshimin eventuale të tij, në procedurë gjyqësore nga Dhoma e Posaçme. Përndryshe, ndryshimi i vendimit administrativ në disfavor të palës që e ka fituar një të drejtë, e cenon edhe sigurinë juridike, si parim juridik.

Siç shihet në rastin konkret vendimi i dytë i AL-së është nxjerrë afër dy vite pas nxjerrjes së vendimit të parë. Gjatë kësaj periudhe kohore, pala paditëse kishte pritshmërinë legjitime se do të ekzekutohet vendimi në vlerën e aprovuar me vendimin e parë. Vendimi i parë në momentin që është nxjerrë është bërë i formës së prerë ngase nuk ka mundur që të atakohet me ankesë nga pala e paditur. Mbi këtë bazë rezulton se vendimi i datës 16.05.2016, nuk ka bazë ligjore. Gjykata e ka në konsideratë faktin se edhe kreditori mund të ketë detyrime ndaj Ndërmarrjes, mirëpo ato çështje sigurisht se mund të adresohen me mjete alternative për zgjidhjen e kontesteve apo eventualisht me padi nga AKP-ja që mund t'i drejtohet gjykatës kompetente. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar dhe në dispozitat ligjore të cituara është vendosur si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e vonësës është i bazuar në neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*. Mbi këtë bazë, gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë lidhur me vlerën prej 10 % të shumës totale të detyrimit, ndërsa e ka refuzuar atë në pjesën tjetër të saj (në shumën e kërkuar në normën prej 8 % në vit).

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar se *“Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë”*. Në këtë çështje kontestimore, pala paditëse ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar ato. Gjykata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur paditësit të drejtën në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi i njëjti e ka fituar gjykimin, në shumat si në vijim: 104.00 €, për përpilimin e padisë nga avokati; dhe 20.00 €, për taksë gjyqësore për padi, në shumën e përgjithshme prej 124.00 €.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
**Mr.sc. Bajram Miftari**